



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0425

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Batisha Ibrahimimi dhe Kimete Gashi - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) ENGINEERING GROUP SH.P.K., kundër Mosekzekutimi i vendimit të OSHP-së të KOMUNA E PEJES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i Impiantit në Jabllanic të Leshanit LOT 1 Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza LOT 2 Ndërtimi rrjetit te kanalizimit fekal në Lugun e Leshanit me numër të prokurimit 635-26-1622-5-1-1, me 17/08/2026, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE ENGINEERING GROUP SH.P.K. me nr. 2026/0425, e datës 25/06/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i Impiantit në Jabllanic të Leshanit LOT 1 Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza LOT 2 Ndërtimi rrjetit te kanalizimit fekal në Lugun e Leshanit me numër të prokurimit 635-26-1622-5-1-1.
2. **Anulohet** njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i Impiantit në Jabllanic të Leshanit LOT 1 Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza LOT 2 Ndërtimi rrjetit te kanalizimit fekal në Lugun e Leshanit me numër të prokurimit 635-26-1622-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES. Obligohet AK që të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 08.04.2026, ENGINEERING GROUP SH.P.K., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me Ndërtimi i Impiantit në Jabllanic të Leshanit LOT 1 Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza LOT 2 Ndërtimi rrjetit të kanalizimit fekal në Lugun e Leshanit me numër të prokurimit 635-26-1622-5-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 1,066,842.70€.

Me 22.06.2026, OE ENGINEERING GROUP SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 22.06.2026, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si e pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 25.06.2026, OSHP ka pranuar ankesën nga OE ENGINEERING GROUP SH.P.K., me nr. 2026/0425 lidhur me aktivitetin Ndërtimi i Impiantit në Jabllanic të Leshanit LOT 1 Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza LOT 2 Ndërtimi rrjetit të kanalizimit fekal në Lugun e Leshanit me numër të prokurimit 635-26-1622-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues ENGINEERING GROUP SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

HYRJE

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Pejës, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Impiantit në Jabllanicë të Leshanit – LOT 1 Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza; LOT 2 Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit fekal në Lugun e Leshanit", me numër të prokurimit 635-26-1622-5-1-1.

Për këtë aktivitet të prokurimit, Operatori Ekonomik Engineering Group Sh.P.K. kishte parashtruar fillimisht Kërkesë për rishqyrtim dhe më pas ankesë pranë OSHP-së, me të cilën kishte kontestuar kriteret diskriminuese, joproporcionale dhe teknikisht të panevojshme të Dosjes së Tenderit, si dhe shkurtimin e kundërligjshëm të afatit për ofertim.

OSHP, me Vendimin PSH. Nr. 2026/0283, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e Operatorit Ekonomik Engineering Group Sh.P.K., e ka anuluar Njoftimin për Kontratë dhe e ka obliguar Autoritetin Kontraktues që të bëjë përmirësimet e nevojshme në Dosjen e Tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Me Konkluzionin për korrigjimin dhe plotësimin e vendimit, OSHP ka sqaruar se korrigjimi ka të bëjë vetëm me eliminimin e një gabimi teknik në titullin e aktivitetit të prokurimit, ndërsa të gjitha pjesët e tjera të Vendimit PSH. Nr. 2026/0283 mbeten të pandryshuara dhe në fuqi.

Rrjedhimisht, Autoriteti Kontraktues ka qenë i detyruar që, pas Vendimit të OSHP-së, të korrigjojë Dosjen e Tenderit në përputhje me dispozitivin e vendimit dhe me konkluzionet e ekspertëve shqyrtues Agnese Ibrahimit dhe Bujar Gashi, të cilët kanë identifikuar qartë kriteret që duhet të largohen, ndryshohen ose harmonizohen me natyrën e kontratës.

Megjithatë, nga shqyrtimi i Dosjes së Tenderit të publikuar pas Vendimit të OSHP-së rezulton se Autoriteti Kontraktues nuk e ka zbatuar vendimin e OSHP-së në mënyrë të plotë dhe të drejtë. Përkundrazi, Dosja e Tenderit vazhdon të përmbajë kriteret e kontestuara, dispozitat e paqarta, kërkesa të papërshtatura me rekomandimet e ekspertit teknik, si dhe afat ofertimi që nuk paraqet zgjatje reale dhe efektive.

Për këtë arsye, më datën 21.06.2026, brenda afatit ligjor, Ankuesi ka paraqitur pranë Autoritetit Kontraktues Kërkesë për rishqyrtim për shkak të moszbatimit të Vendimit të OSHP-së me Nr. 2026/0283.

Autoriteti Kontraktues, menjëherë, më datën 22.06.2026, ka nxjerrë vendim me të cilin ka refuzuar si të pabazuar Kërkesën për rishqyrtim të Ankuesit, me arsyetimin se kinse janë adresuar të gjitha kërkesat e Vendimit të OSHP-së Nr. 2026/0283.

MOSZBATIMI I VENDIMIT TË OSHP-SË DHE I KONKLUZIONEVE TË EKSPERTIT

Vendimi PSH. Nr. 2026/0283, me të cilin i është dhënë besimi raportit të ekspertëve, ka konstatuar se:

- a) Afati ligjor për dorëzimin e ofertave është shkurtuar në kundërshtim me rregullat për shkurtime të afateve dhe, rrjedhimisht, duhet të jetë i plotë së paku 40 ditë.
- b) ISO 9001 për LOT 2 nuk është i domosdoshëm.
- c) ISO 14001 nuk duhet të jetë kriter eliminues dhe, rrjedhimisht, duhet të hiqet nga Dosja e Tenderit.
- d) ISO 3824-2:2021 për saldim me shkrirje të metaleve duhet të hiqet, pasi nuk është kriter proporcional.
- e) ISO 39001:2021 duhet të hiqet, pasi është kriter joproporcional.
- f) Kërkesa për inxhinier të ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, me ISO OHSAS 18001:2007 dhe ISO 14001:2015, duhet të largohet, sepse në këtë rast nuk ka lidhje direkte me natyrën kryesore të kontratës, përderisa kërkohet një ekspert për Siguri dhe Shëndet në Punë.
- g) Kriteret ISO 9001:2015 dhe certifikata për menaxhimin e kontratave FIDIC duhet të largohen, sepse kontratat FIDIC nuk mund të aplikohen sipas rregullave të prokurimit publik.
- h) Kërkesa për inxhinier të diplomuar ose master të mbrojtjes së ambientit duhet të largohet, sepse në këtë rast nuk ka lidhje direkte me natyrën kryesore të kontratës.

i) Për pikën 5 – Inxhinier i diplomuar ose master i hidroteknikës – ky kriter duhet të largohet, sepse në këtë rast janë të mjaftueshëm dy inxhinierë të hidroteknikës të angazhuar. Po ashtu, nuk është e nevojshme që të jetë i certifikuar për menaxhimin dhe trajtimin e ujërave, pasi gjatë fazës së studimeve të gjithë hidroinxhinierët i janë nënshtruar lëndëve dhe provimeve përkatëse për trajtimin e ujërave, menaxhimin e tyre etj.

Duke pasur parasysh se lloji i kontratës është ekzekutues dhe jo projektues, operatori ekonomik ka për detyrë vetëm ekzekutimin e punimeve sipas përshkrimit teknik, paramasës dhe pjesës grafike.

j) Kërkesa për një teknik të arkitekturës duhet të largohet, pasi në këtë rast nuk ka lidhje direkte me natyrën kryesore të kontratës.

k) Kërkesa për një teknik të makinerisë duhet të largohet, pasi në këtë rast nuk ka lidhje direkte me natyrën kryesore të kontratës.

l) Kërkesa për një specialist të certifikuar si autokranist duhet të largohet, pasi në këtë rast nuk kemi autokrana me kapacitet të lartë. Peshë e pushtave të kanalizimit është rreth 400-700 kg dhe mund të menaxhohet edhe me eskavator ose me metoda të tjera teknike.

m) Për një projekt të tillë, me rreth 8 km rrjet kanalizimi, thellësi 1.5-4.0 m, diametra Ø200-Ø630 mm, kryesisht në ara dhe me kategori të dheut sipas paramasës II-IV, sipas praktikës inxhinierike dhe organizimit normal të punimeve, zgjedhja kryesore duhet të jetë eskavatori me gusenica (crawler excavator), dhe jo eskavatori me goma.

n) Kërkesa për eskavator me peshë minimale 38-45 ton duhet të largohet, pasi nuk ka lidhje direkte me natyrën kryesore të kontratës.

o) Kërkesa që operatori ekonomik të dëshmojë se posedon ose ka në dispozicion kapacitet transportues adekuat për bartjen e makinerive të rënda deri në minimum 30 ton duhet të largohet, pasi nuk ka lidhje direkte me natyrën kryesore të kontratës.

p) Kërkesa për eskavator me goma minimum 20 ton duhet të largohet, pasi nuk ka lidhje direkte me natyrën kryesore të kontratës.

q) Kërkesa për eskavator me peshë minimale 4 ton duhet të largohet, pasi nuk ka lidhje direkte me natyrën e kontratës dhe krijon mundësi për favorizim të operatorëve ekonomikë që posedojnë një pajisje të tillë.

r) Kërkesa për cilindër për ngjeshje me dhëmbëza maksimum 1.5 ton duhet të largohet, pasi nuk ka lidhje direkte me natyrën kryesore të kontratës.

s) Kërkesa për rimorkio me pajisje elektrike për sinjalizim të punimeve në rrugë me peshë totale deri në 300 kg duhet të largohet, pasi në këtë rast nuk ka lidhje direkte me natyrën kryesore të kontratës.

t) Kërkesa për gjenerator elektrik mbi 375 kVA duhet të largohet, pasi në këtë rast nuk ka lidhje direkte me natyrën kryesore të kontratës.

u) Kërkesa për pajisje lazer minimum 4 kW për prerje të çelikut deri në 20 mm trashësi duhet të largohet, pasi në këtë rast nuk ka lidhje direkte me natyrën kryesore të kontratës.

v) Kërkesa për pajisje/automjet për pastrimin e kanalizimeve, si dhe të rrugës, duhet të largohet, pasi në këtë rast nuk ka lidhje direkte me natyrën kryesore të kontratës.

w) Sa i përket kërkesave për: çekiç hidraulik që vendoset në eskavator, gërshërë hidraulike që montohen në eskavator, makinë për lakimin e armaturave, traktor me rimorkio, makinë hidraulike për ngjeshjen e dheut që montohet në eskavator, cilindër vibruës me goma me peshë 8 dhe 3 ton, të gjitha këto kritere duhet të largohen, pasi nuk përkojnë me natyrën e punëve që do të ekzekutohen sipas kontratës.

OSHP dhe ekspertët shqyrtues nuk i kanë dhënë Autoritetit Kontraktues diskrecion që ta zbatojë vetëm pjesërisht apo në mënyrë selektive raportin e ekspertizës. OSHP e ka aprovuar ankesën dhe e ka obliguar Autoritetin Kontraktues që të bëjë përmirësimet e nevojshme në Dosjen e Tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Ky obligim nuk nënkupton vetëm ndryshim formal të datës së hapjes së tenderit, por kërkon korrigjim real të Dosjes së Tenderit në përputhje me gjetjet teknike dhe juridike të raportit të ekspertëve.

Ekspertët Agnese Ibrahimit dhe Bujar Gashi kanë konstatuar se ankesa ishte e bazuar sa i përket shkurtimit të afatit, pasi Njoftimi Paraprak nuk ishte publikuar së paku 40 ditë para publikimit të Njoftimit për Kontratë.

Sipas ekspertëve shqyrtues, Autoriteti Kontraktues nuk kishte vepruar në përputhje me nenin 45 të LPP-së, nenet 6.5 dhe 6.6 të Rregullores për Prokurim Publik, si dhe pikën 6 të Udhëzuesit për Prokurim Publik.

Përkundër këtij konstatimi, Dosja e Tenderit vazhdon të përmbajë formulimin se aktiviteti zhvillohet me afat të përshpejtuar, duke u bazuar në Njoftimin Paraprak.

Ky formulim është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me konstatimin e ekspertëve dhe Vendimin e OSHP-së, pasi pikërisht përdorimi i afatit të përshpejtuar ishte konstatuar si i pabazuar dhe i kundërligjshëm.

Për më tepër, Dosja e Tenderit mban datën e përgatitjes 31.03.2026 dhe afatin për dorëzim/hapje të tenderëve më 30.06.2026, ndonëse Vendimi i OSHP-së është nxjerrë më 15.06.2026.

Një afat prej vetëm disa ditësh pas Vendimit të OSHP-së nuk mund të konsiderohet zgjatje reale dhe efektive e afatit për ofertim. Kjo paraqet vetëm një zgjatje formale dhe nuk u mundëson operatorëve ekonomikë që, pas korrigjimit real të Dosjes së Tenderit, të përgatisin ofertat në mënyrë të barabartë, të plotë dhe konkurruese.

Autoriteti Kontraktues ka qenë i detyruar që, pas Vendimit të OSHP-së, të publikojë Dosje të korrigjuar dhe të caktojë afat të ri të mjaftueshëm për ofertim, i cili duhet të llogaritet nga publikimi i Dosjes së korrigjuar.

Në të kundërtën, Vendimi i OSHP-së mbetet i pazbatuar në aspektin thelbësor. Kjo nënkupton se afati duhet të jetë i plotë nga data e korrigjimit të Dosjes së Tenderit deri në ditën e hapjes së ofertave.

II. MOSPËRSHTATJA E LISTËS SË PAJISJEVE ME KONSTATIMET E EKSPERTIT TEKNIK

Eksperti teknik Bujar Gashi ka dhënë konkluzione konkrete lidhur me pajisjet dhe stabilimentet që janë joproporcionale, diskriminuese ose teknikisht të panevojshme për këtë kontratë.

Këto konkluzione nuk janë rekomandime të përgjithshme, por orientime konkrete se cilat kritere duhet të largohen ose të zëvendësohen me kërkesa proporcionale dhe të lidhura me objektin e kontratës.

Përkundër kësaj, në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit për LOT 1 vazhdojnë të figurojnë pajisje të cilat eksperti teknik ka konstatuar se duhet të largohen ose të ndryshohen, përfshirë:

Eskavator me goma minimum 20 ton;

Eskavator me peshë minimum 38 ton;

Gjysmërimorkio për bartje të makinerisë minimum 30 ton;

Eskavator me peshë minimum 4 ton;

Rimorkio me pajisje elektrike për sinjalizim të punimeve në rrugë me peshë totale deri në 300 kg;

Vibroplakë që montohet në eskavator.

Eksperti teknik ka konstatuar se për këtë projekt zgjedhja profesionale dhe teknike është pranueshme është eskavatori kryesor 18-26 ton me gusenica/zinxhirë, dhe jo eskavatori 38-45 ton apo eskavatori me goma 20 ton.

Sipas ekspertit, kërkesa për eskavator 38-45 ton duhet të largohet, sepse nuk ka lidhje direkte me natyrën e kontratës dhe është joproporcionale për një rrjet kanalizimi me thellësi deri në rreth 4 metra dhe diametra të gypave të parapara në projekt.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk e ka zbatuar këtë konkluzion. Në vend që ta zëvendësojë kriterin me kërkesën e rekomanduar për eskavator 18-26 ton me gusenica/zinxhirë, në Dosjen e Tenderit vazhdon të mbetet kërkesa për eskavator me peshë minimale 38 ton.

Ky veprim paraqet moszbatim të drejtpërdrejtë të Vendimit të OSHP-së dhe të konkluzionit teknik të ekspertit.

Eksperti teknik ka konstatuar gjithashtu se kërkesa për gjysmërimorkio për bartjen e makinerive me kapacitet minimal 30 ton duhet të largohet, pasi për këtë projekt është i mjaftueshëm një kapacitet transportues adekuat deri në minimum 26 ton. Sipas ekspertit, kërkesa për 30 ton nuk lidhet drejtpërdrejt me natyrën e kontratës dhe mund të jetë problematike edhe në raport me kufizimet e infrastrukturës rrugore.

Megjithatë, Dosja e Tenderit vazhdon ta përmbajë kërkesën për gjysmërimorkio me kapacitet minimal 30 ton, duke mos respektuar konkluzionin e ekspertit teknik dhe obligimin e përcaktuar nga Vendimi i OSHP-së.

Eksperti teknik ka konstatuar se kërkesa për eskavator me goma minimum 20 ton duhet të largohet, pasi kjo kërkesë favorizon operatorë të caktuar ekonomikë dhe nuk është e domosdoshme për natyrën e punimeve që do të realizohen.

Përkundër këtij konstatimi, kërkesa për eskavator me goma minimum 20 ton vazhdon të figurojë në listën e pajisjeve të kërkuara për LOT 1.

Eksperti teknik ka konstatuar gjithashtu se kërkesa për rimorkio me pajisje elektrike për sinjalizim të punimeve me peshë totale deri në 300 kg duhet të largohet, pasi operatori ekonomik mund të dëshmojë realizimin e sinjalizimit të punimeve përmes shenjave përkatëse, masave të sigurisë dhe metodologjisë së punës.

Megjithatë, kjo pajisje vazhdon të mbetet pjesë e Aneksit 7 të Dosjes së Tenderit, pavarësisht se është konstatuar si kriter i panevojshëm dhe joproporcional.

Edhe për LOT 2, Dosja e Tenderit vazhdon të përmbajë pajisje të cilat eksperti teknik ka konstatuar se duhet të largohen ose të harmonizohen me natyrën reale të punimeve, përfshirë:

Cilindër vibrues me peshë minimale 8 ton;

Cilindër gomë-gomë maksimum 3 ton;

Makineri hidraulike për ngjeshjen e dheut që montohet në bager;

Çekiç hidraulik që montohet në bager;

Makinë për lakimin e armaturës;

Kamion vetëshkarkues me peshë të gjithmbarshme minimale 32 ton;

Kamion vetëshkarkues/kiper-kran me peshë të gjithmbarshme minimale 18 ton;

Kamionetë kiper me vinç me kapacitet bartës maksimal 0.8 ton;

Traktor dhe rimorkio kiper për traktor;

Eskavator me rrota me peshë minimale 15 ton;

Pajisje të tjera që në mënyrë të panevojshme përcaktojnë metodologjinë e realizimit të punimeve nga kontraktori, pa qenë të ndërlidhura domosdoshmërisht me rezultatin teknik të kontratës.

Gjithashtu, pjesë e kërkesave të pajisjeve janë edhe:

Kovë për përzierjen e betonit që montohet në bager;

Gërshërë hidraulike;

Çekiç hidraulik që montohet në bager;

Makinë për lakimin e armaturës;

Autobetoniere vetëngarkuese për përzierjen e betonit, minimum 3 ton;

Mini-eskavator me goma për hapjen e kanaleve në mënyrë të shpejtë, me zinxhirë, maksimum 5 ton;

Mini-eskavator me zinxhir gome, minimum 3.5 ton.

Eksperti teknik ka konstatuar se disa nga këto pajisje, si çekiçi hidraulik, makineritë hidraulike që montohen në eskavator, traktorët me rimorkio, makinat për lakimin e armaturës dhe cilindrat e caktuar, nuk përkojnë me natyrën e punëve që do të ekzekutohen sipas kontratës.

Përkundër këtij konstatimi, Autoriteti Kontraktues i ka lënë këto kërkesa në Dosjen e Tenderit, duke mos respektuar konkluzionet teknike të ekspertit shqyrtues.

Kjo qasje tregon se Autoriteti Kontraktues nuk e ka zbatuar raportin e ekspertit në mënyrë të plotë dhe të drejtë, por ka bërë ndryshime selektive, duke larguar disa kërkesa dhe duke lënë në fuqi kërkesa të tjera të cilat janë konstatuar si diskriminuese, të panevojshme ose joproporcionale.

OSHP e ka obliguar Autoritetin Kontraktues që, krahas përmirësimeve në Dosjen e Tenderit, të zgjasë afatin për ofertim. Qëllimi i zgjatjes së afatit është që operatorëve ekonomikë t'u jepet kohë e mjaftueshme për të analizuar Dosjen e korrigjuar të Tenderit, për të përgatitur ofertat, për të siguruar dokumentet e kërkuara dhe për të marrë pjesë në një proces konkurrues, të lirë dhe të barabartë.

Nëse afati i ri për dorëzim mbetet më datën 30.06.2026, ndërsa Vendimi i OSHP-së është nxjerrë më 15.06.2026 dhe Dosja e rishikuar është publikuar më datën 17.06.2026, atëherë operatorët ekonomikë nuk kanë pasur kohë reale dhe të mjaftueshme për të përgatitur ofertat mbi bazën e një Dosjeje të korrigjuar.

Kjo e bën zgjatjen e afatit vetëm formale dhe e zbraz nga përmbajtja Vendimin e OSHP-së.

Autoriteti Kontraktues është i detyruar të caktojë afat të ri të mjaftueshëm, i cili duhet të llogaritet nga data e publikimit të Dosjes së korrigjuar. Duke qenë se në rastin konkret është konstatuar se kushtet për aplikimin e afatit të përsheptuar nuk janë plotësuar, afati duhet të jetë jo më i shkurtër se afati minimal ligjor për kontrata me vlerë të madhe, përkatësisht 40 ditë.

Moszbatimi i Vendimit të OSHP-së dhe mbajtja në fuqi e kriterëve joproporcionale e dëmton drejtpërdrejt Operatorin Ekonomik Engineering Group Sh.P.K., pasi e vendos atë në pozitë të pabarabartë krahasuar me operatorët ekonomikë të cilët mund të kenë në dispozicion pajisje specifike të kërkuara pa nevojë reale teknike.

Këto kriterë kufizojnë konkurrencën, rrisin artificialisht barrën e ofertimit, krijojnë rrezik për eliminim të padrejtë dhe e bëjnë të pamundur pjesëmarrjen në kushte të barabarta.

Dëmi nuk është vetëm individual, por prek edhe interesin publik, pasi konkurrenca e kufizuar rrit rrezikun që Autoriteti Kontraktues të pranojë më pak oferta dhe çmime më të larta, në kundërshtim me parimin e ekonomicitetit dhe efikasitetit të prokurimit publik.

Rrjedhimisht, për shkak të moszbatimit të Vendimit përfundimtar administrativ, me respekt kërkohet nga OSHP-ja që të ketë në konsideratë ndërmarrjen e masave të cilat janë përcaktuar në nenet 130 dhe 131 të Ligjit për Prokurimin Publik.

PËRGJIGJET NGA NJËSIA KËRKUESE LIDHUR ME PRETENDIMIN E OPERATORIT EKONOMIK

Pretendimet e Operatorit Ekonomik se Autoriteti Kontraktues nuk e ka zbatuar Vendimin e OSHP-së janë të pabazuara, si në aspektin faktik ashtu edhe në atë juridik.

Pas pranimit të Vendimit të OSHP-së, Autoriteti Kontraktues ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për harmonizimin e Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë, në përputhje me konstatimet dhe rekomandimet e Panelit Shqyrtues.

Të gjitha ndryshimet e kërkuara janë reflektuar në dokumentacionin e tenderit dhe janë publikuar në platformën elektronike të prokurimit.

1. Lidhur me kërkesat për stafin profesional

Një nga çështjet kryesore të ngritura nga Operatori Ekonomik në ankesën paraprake pranë OSHP-së kishte të bënte me kërkesat për stafin profesional, përkatësisht me angazhimin e inxhinierëve të caktuar.

Autoriteti Kontraktues ka respektuar plotësisht konstatimet e OSHP-së dhe, në përputhje me Vendimin e saj, ka larguar nga kërkesat e Dosjes së Tenderit pozicionet dhe profilet profesionale të cilat kanë qenë objekt i pretendimeve të Operatorit Ekonomik.

Për rrjedhojë, kriteret aktuale të kualifikimit profesional nuk përmbajnë më kërkesat e kontestuara nga Operatori Ekonomik dhe, për këtë arsye, pretendimi se Vendimi i OSHP-së nuk është zbatuar është i pasaktë dhe në kundërshtim me gjendjen faktike të dokumentacionit të tenderit.

2. Lidhur me Aneksin 7 – Listën e Pajisjeve

Sa i përket pretendimeve lidhur me Aneksin 7 – Lista e Pajisjeve, Autoriteti Kontraktues ka bërë rishikimin dhe harmonizimin e plotë të kërkesave teknike, në pajtim me Vendimin e Panelit Shqyrtues.

Në dokumentacionin e ndryshuar janë përcaktuar qartë kërkesat minimale teknike për pajisjet e nevojshme për realizimin e kontratës, duke përfshirë edhe specifikimin e minimumit të kapacitetit dhe peshës së pajisjeve, aty ku kjo kërkohet nga natyra dhe kompleksiteti i punimeve.

Këto kërkesa janë përcaktuar në mënyrë objektive, proporcionale dhe të arsyeshme, duke pasur për qëllim sigurimin e kapaciteteve minimale për realizimin e kontratës dhe jo kufizimin e konkurrencës.

Për më tepër, në vetë Listën e Pajisjeve është sqaruar në mënyrë eksplicite se operatorët ekonomikë mund të dëshmojnë disponueshmërinë e pajisjeve jo vetëm përmes pronësisë, por edhe përmes marrëveshjeve për shfrytëzim, qira, huazim apo formave të tjera të lejuara sipas legjislacionit në fuqi.

Kjo nënkupton se çdo operator ekonomik ka mundësi reale dhe të barabartë për të përmbushur kriteret e kërkuara, pa qenë domosdoshmërisht pronar i pajisjeve, gjë që eliminon çdo pretendim

për diskriminim apo kufizim të konkurrencës.

3. Mungesa e provave për pretendimet e Operatorit Ekonomik

Autoriteti Kontraktues vëren se në Kërkesën për Rishqyrtim, Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnjë provë konkrete, asnjë dispozitë specifike të Dosjes së Tenderit dhe asnjë argument juridik që do të dëshmonte se cili element i Vendimit të OSHP-së nuk është zbatuar.

Pretendimet e paraqitura mbeten deklarative dhe nuk mbështeten në fakte apo dokumente që do të provonin mospërputhjen e Dosjes së Tenderit me Vendimin e OSHP-së.

Sipas praktikës së vazhdueshme të OSHP-së dhe parimeve themelore të procedurës administrative, barra e provës për pretendimet e ngritura bie mbi palën që i paraqet ato.

Në rastin konkret, Operatori Ekonomik nuk ka arritur të argumentojë dhe as të dëshmojë ekzistimin e ndonjë shkeljeje konkrete nga Autoriteti Kontraktues.

4. Përputhshmëria me Ligjin për Prokurimin Publik

Autoriteti Kontraktues konsideron se kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit janë në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe ndryshimet e tij.

Kriteret e vendosura:

janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës;

janë proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e punimeve;

nuk favorizojnë dhe nuk diskriminojnë asnjë operator ekonomik;

garantojnë trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë;

sigurojnë konkurrencë efektive në procedurën e prokurimit.

Për rrjedhojë, pretendimet për shkelje të Ligjit për Prokurimin Publik apo për moszbatim të Vendimit të OSHP-së nuk qëndrojnë.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 30.06.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0425/2026, ndërsa me datë 05.07.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0425 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, Autoriteti kontraktues nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE nuk pergjigjet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit

shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE ENGINEERING GROUP SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0425 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimet ankimore të OE ankues janë që AK nuk e ka zbatuar vendimin e OSHP:2026/0283 të dt. 08.06.2026. Përmes këtij vendimi është miratuar si pjesërisht e bazuar ankesa e OE ankues me arsyetimin se Paneli Shqyrtues i ka faluar besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik. Ndërsa sipas raportit të ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik të dt. 18.05.2026, AK duhet të largoj/ndryshoj nga dosja e tenderit kërkesat e formulara si në vijim:

1. ISO standard -ISO 9001 2015 - Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë –
2. ISO 3834-2 2021 – Certifikata për Saldimin me shkrirje të metaleve Metalike-
3. ISO 39001 2012 per permirsimin ne siguris në punë
4. Një Inxhinier (master) i diplomuar i Mbrojtjes së Ambientit, me 5 vite përvojë pune në fushën e njëjtë ose të ngjashme
5. Inxhinieri i diplomuar ose master i hidroteknikës
6. inxhinier i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv, ISO OHSAS 18001 2007 dhe ISO 14001 2015
7. Certifikat për menaxhimin e kontratave FIDIC
8. Një Teknik i arkitektures, këtë kriter duhet larguar sepse në këtë rast nuk ka lidhje direkte me natyrën kryesore të kontratës,
9. Një Teknik të makinerisë, këtë kriter duhet larguar sepse në këtë rast nuk ka lidhje direkte me natyrën kryesore të kontratës,
10. një specialist i certifikuar si auto kranist,
11. kemi auto kran të kapacitet të lartë, pesha e pushtave të kanalizimit është 400-700 kg dhe mund të monitorohen edhe me Eskavator ose metodologji teknike,
12. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se posedon ose ka në dispozicion kapacitet transportues adekuat (në pronësi, qira, leasing ose marrëveshje bashkëpunimi) për bartjen e makinerive të rënda deri në minimum 30 ton,
13. Cilinder për ngjeshje me dhembëza max. 1.5 ton –
14. Rimorkio me pajisje elektrike për sinjalizim të punimeve në rrugë me peshë totale deri 300 kg
15. Eskavator me goma min 20 ton

16. Generator elektrik mbi 375 kVa
17. Paisje laser minimum 4kW per prerje te çelikut deri ne 20mm trashesi
18. Paisja Automjet per pastrimin e kanalizimeve si dhe te rruges
19. Çekan hidraulik qe vendoset ne eskavator,
20. Gersher Hidraulike qe montohen ne Eskavator,
21. Makina per lakimin e Armaturave,
22. Traktor me rimorkio,
23. Makine hidraulike per ngjeshjen e dheut qe montohet ne eskavator,
24. Cilindervibrues me goma me pesha 8 dhe 3 ton.
25. Eskavator minimum me pesha 38-45 ton - Eskavatori kryesor 18 – 26 ton me gusenica/zingjiror,

Eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimet ankimore të ankesës OSHP:2026/0425 ashtu që ka krahasuar kërkesat dhe të gjeturat e vendimit OSHP:2026/0283 dhe veprimet e AK në drejtim të zbatimit të vendimit të OSHP. Me këtë rast eksperti shqyrtues ka konstatuar që nga të gjitha kërkesat e DT që eksperti shqyrtues sipas vendimit 2026/0283 ka kërkuar të largohen, AK ende nuk ka larguar/ndryshuar kërkesat si në vijim:

Për (LOT-1):

1. Eskavator me goma min 20 ton (duhet ndryshuar pasha në min. 18 ton)
2. Rimorkio me pajisje elektrike per sinjalizim te punimeve ne rruge me peshe total deri 300 kg
3. Ekskavator min pesha min 38t (duhet ndryshuar pasha në min. 26 ton)

Për (LOT-2):

4. ISO standard -ISO 9001 2015 - Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë –
5. ISO 3834-2 2021 - Certifikata për Saldimin me shkrirje të metaleve Metalike-
6. ISO 39001 2012 per permirsimin ne siguris në punë
7. Një Inxhinier (master) i diplomuar i Mbrojtjes se Ambientit, me 5 vite përvojë pune ne fushën e njëjtë ose te ngjashme
8. një teknik te makinerisë
9. një specjalisht i certifikur si kranist

10. Çekan hidraulik qe montohet ne bager

11. Makine hidraulike per ngjeshjen e dheut qe montohet ne bager

Të gjitha kërkesat tjera të DT janë larguar/ndryshuar saktësisht sipas të gjeturave të vendimit të OSHP:2026/0283 përkatësisht sipas ekspertëve të kësaj ankese. Nga sa u tha më sipër, është gjetur se pretendimet ankimore sipas ankesës 2026/0425 janë pjesërisht të bazuara ndërsa AK duhet të ndryshoj/largoj edhe kërkesat e evidentuara më sipër.

Vlen të shtohet po ashtu që në raportin e ekspertëve të vendimit OSHP:2026/0283 në disa vende është kërkuar që të shtohet kritere të reja në dosjen e tenderit. Mirëpo vendosja e kërkesave në DT nuk është kompetencë e ekspertëve por është kompetencë ekskluzive e AK. Përndryshe vendosja e kërkesave të reja gjatë procedurës e sipër sikurse është rekomanduar nga ekspertët në rastin konkret përbën shkelje flagrante të nenit 7 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohej në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse nuk ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 2, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Prandaj, Paneli në këtë rast me datë 06.08.2026, mbajti seancë ku të ftuar ishin të gjitha palët përfshirë përfaqësuesit e OE, përfaqësuesit e AK, eksperti profesional.

Kryetari i panelit hapi seancën e shqyrtimit kryesorë të ankesës në ora 10:30 ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesit e OE-ve ankuese, eksperti shqyrtues. Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me përbërjen e panelit, dhe pasi konstatoi se nga të pranishmit nuk pati vërejtje në këtë përbërje, vazhdoi me seancën.

Autoriteti Kontraktues pasi konfirmojë përmes emailit elektronik se nuk mund të jetë i pranishëm në seancë.

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me objektin e shqyrtimit si dhe me shkresat e lëndës dhe në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të OE-së se ankues **Engineering Group SH.P.K., - Z. Avokat Isuf Zejna dhe z. Fidan Povataj** të cilët delaruan:

Mbetemi në tërësi pranë ankesës së Operatorit Ekonomik Engineering Group Sh.P.K., të paraqitur në kuadër të aktivitetit të prokurimit me numër të prokurimit 635-26-1622-5-1-1. Çështja kryesore që kërkon vlerësimin e Panelit është nëse e ka zbatuar në mënyrë të plotë, të drejtë dhe efektive Vendimin e OSHP-së PSH. Nr. 2026/0283 dhe konkluzionet e ekspertëve shqyrtues Agnese Ibrahimit dhe Bujar Gashi.

Me vendimin e lartcekur, OSHP e ka aprovuar si të bazuar ankesën e Engineering Group Sh.P.K., e ka anuluar njoftimin për kontratë dhe e ka obliguar Autoritetin Kontraktues që të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim. AK ka bërë formalisht me konkluzionin për korrigjimin dhe plotësimin e vendimit disa korrigjime ndërsa pjesët kryesore sidomos sa i përket makinerisë kanë mbetur të pandryshuara.

Në dosjen e rishikuar vazhdojnë të mbeten kritere dhe pajisje të cilat eksperti teknik i ka identifikuar shprehimisht si të panevojshme, joproporcionale ose të palidhura drejtpërdrejt me natyrën e kontratës. Ndër to përfshihen kërkesat për eskavator me peshë minimum 38 ton, eskavator me goma, gjysmërimorkio me kapacitet minimum 30 ton, rimorkio me pajisje elektrike për sinjalizim, çekiçë dhe gërshërë hidraulike, makina për lakimin e armaturës, traktorë me rimorkio, cilindërvibrues dhe pajisje të tjera që ndërhyjnë në mënyrë të panevojshme në metodologjinë e realizimit të punimeve.

Eksperti teknik nuk ka dhënë rekomandime të përgjithshme, por ka identifikuar konkretisht kërkesat që duhet të largohen ose të përshtaten me natyrën reale të kontratës.

Moszbatimi është veçanërisht i dukshëm edhe sa i përket afatit për ofertim. Ekspertët kanë konstatuar se kushtet për përdorimin e afatit të përshpejtuar nuk kanë qenë të plotësuara dhe se duhet të zbatohet afati i plotë prej së paku 40 ditësh. Përkundër kësaj, dosja e rishikuar është publikuar më 17.06.2026, ndërsa afati për dorëzimin e ofertave është caktuar më 30.06.2026. Një periudhë e tillë nuk përbën zgjatje reale të afatit, por vetëm ndryshim formal të datës, i cili nuk u mundëson operatorëve ekonomikë që të analizojnë dosjen e korrigjuar dhe të përgatisin ofertat në kushte të barabarta.

Mbajtja në fuqi e këtyre kërkesave e dëmton drejtpërdrejt Ankuesin, kufizon konkurrencën dhe krijon rrezik real për eliminim të padrejtë të ofertave. Njëkohësisht, cenon edhe interesin publik, sepse kufizimi i pjesëmarrjes mund të rezultojë me numër më të vogël ofertash dhe me çmime më të larta. Sa i përket ekspertizës së ekspertit Visar Shehu ne nuk jemi pajtuar me të pasi që ka disa mangësi:

1. Përkundër kësaj, në Aneksin 7 të dosjes së tenderit për LOT 1 vazhdojnë të figurojnë pajisje të cilat eksperti teknik ka konstatuar se duhet të largohen ose të ndryshohen, përfshirë:

- o Eskavator me goma minimum 20 ton;

- o Eskavator me peshë minimum 38 ton;

- o Gjysmërimorkio për bartje të makinerisë minimum 30 ton;

- o Eskavator me peshë minimum 4 ton;

- o Rimorkio me pajisje elektrike për sinjalizim të punimeve në rrugë me peshë totale deri në 300 kg;

- o Vibroplakë që montohet në eskavator;

Eksperti ka listuar pajisjet që duhet të hiqen:

- o Eskavator me goma minimum 20 ton;

- o Eskavator me peshë minimum 38 ton;

- o Rimorkio me pajisje elektrike për sinjalizim të punimeve në rrugë me peshë totale deri në 300 kg;

Mungojnë:

o Gjysmërimorkio për bartje të makinerisë minimum 30 ton;

o Eskavator me peshë minimum 4 ton;

o Vibroplakë që montohet në eskavator;

2. Edhe për LOT 2, dosja e tenderit vazhdon të përmbajë pajisje të cilat eksperti teknik ka konstatuar se duhet të largohen ose të harmonizohen me natyrën reale të punimeve, përfshirë:

o Cilindërvibrues me peshë minimum 8 ton;

o Cilindër gomë-gomë maksimum 3 ton;

o Makine hidraulike për ngjeshjen e dheut që montohet në bager;

o Çekan hidraulik që montohet në bager;

o Makine për lakimin e armaturës;

o Kamion vetëshkarkues me peshë të gjithmbarshme minimum 32 ton;

o Kamion vetëshkarkues/kipër-kran me peshë të gjithmbarshme minimum 18 ton;

o Kamionetë kiper me vinç me peshëbartje maksimum 0.8 ton;

o Traktor dhe rimorkio kiper për traktor;

o Eskavator me rrota me peshë minimum 15 ton;

o Kove për përzierjen e betonit që montohet në bager

Eksperti ka listuar pajisjet që duhet të hiqen:

Cekan hidraulik që montohet në bager

Makine hidraulike për ngjeshjen e dheut që montohet në bager

Nuk i ka përmendur:

- Cilindër me peshe 8 t
- Cilindër gomë-gomë max 3 ton
- Makine për lakimin e armaturës
- Kamion vetëshkarkues kiper me peshe 32t
- Kamion me kiper me vinç 0.8
- Traktor dhe rimorkio kiper
- Eskavator me rrota me peshe min 15 ton

Për këto arsye, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që ta aprovojë ankesën si të bazuar, të konstatojë se Vendimi PSH. Nr. 2026/0283 nuk është zbatuar plotësisht dhe ta detyrojë Autoritetin Kontraktues që ta korrigjojë dosjen e tenderit dhe Aneksin 7 në përputhje me konkluzionet e ekspertëve. Pas publikimit të dosjes së korrigjuar, duhet të caktohet afat i ri prej 40 ditësh për ofertim.

Të nderuar anëtarë të Panelit Shqyrtues, nga shqyrtimi i provave, dosjes së tenderit dhe ekspertizave të administruara është vërtetuar se Autoriteti Kontraktues nuk e ka zbatuar në mënyrë të plotë dhe efektive Vendimin e OSHP-së PSH. Nr. 2026/0283 dhe konkluzionet e ekspertëve Agnese Ibrahimit dhe Bujar Gashi. Ndryshimet e bëra në dosjen e tenderit kanë mbetur kryesisht formale, ndërsa në Aneksin 7 vazhdojnë të figurojnë pajisje të cilat janë konstatuar si të panevojshme, joproporcionale ose të palidhura drejtpërdrejt me natyrën e kontratës. Ekspertiza e ekspertit Visar Shehu nuk i ka trajtuar në mënyrë të plotë këto mospërputhje. Për LOT 1, eksperti ka përmendur vetëm eskavatorin me goma minimum 20 ton, eskavatorin minimum 38 ton dhe rimorkion për sinjalizim, ndërsa ka lënë pa trajtuar gjysmërimorkion minimum 30 ton, eskavatorin minimum 4 ton dhe vibropllakën që montohet në eskavator. Edhe për LOT 2 janë trajtuar vetëm çekani hidraulik dhe makina hidraulike për ngjeshjen e dheut, ndërsa janë lënë pa u vlerësuar cilindri vibrues minimum 8 ton, cilindri gomë-gomë maksimum 3 ton, makina për lakimin e armaturës, kamionët e kërkuar, traktori me rimorkio dhe eskavatori me rrota minimum 15 ton. Këto mangësi e bëjnë ekspertizën jo të plotë dhe të pamjaftueshme për të konstatuar se vendimi paraparak i OSHP-së është zbatuar.

Moszbatimi i vendimit është i dukshëm edhe në raport me afatin për ofertim, pasi dosja e rishikuar është publikuar më 17.06.2026, ndërsa afati për dorëzimin e ofertave është caktuar më 30.06.2026, ndonëse ekspertët kishin konstatuar se nuk ekzistonin kushtet për përdorimin e afatit të përshpejtuar dhe se duhej të zbatohesh afati i plotë prej së paku 40 ditësh. Mbajtja në fuqi e kritereve të kontestuara dhe caktimi i një afati vetëm formal kufizojnë konkurrencën, e vendosin Ankuesin në pozitë të pabarabartë dhe krijojnë rrezik për eliminim të padrejtë të operatorëve ekonomikë. Për këto arsye, propozojmë që ankesa të aprovohet si e bazuar, të konstatohet se Vendimi PSH. Nr. 2026/0283 nuk është zbatuar plotësisht dhe Autoriteti Kontraktues të detyrohet ta korrigjojë dosjen e tenderit dhe Aneksin 7 në përputhje me konkluzionet e ekspertëve, si dhe, pas publikimit të dosjes së korrigjuar, të caktojë afat të ri prej 40 ditësh për dorëzimin e ofertave".

Eksperti Shqyrtues, në seancë deklaroi se: "Raporti im ka pasur për objekt verifikimin nëse Autoriteti Kontraktues e ka zbatuar vendimin e Panelit nr. 2026/0283 që është marrë paraprakisht gjatë këtij aktiviteti të prokurimit. Për këtë arsye kam bërë një krahasim të drejtpërdrejtë ndërmjet tri dokumenteve: vendimit të OSHP-së, dosjes së tenderit të korrigjuar dhe pretendimeve të ankuesit. Nga ky krahasim kam konstatuar se ankesa është vetëm pjesërisht e bazuar. Së pari, është me rëndësi të theksohet se Autoriteti Kontraktues ka zbatuar pjesën më të madhe të vendimit të Panelit. Shumica e kritereve që në vendimin 2026/0283 ishin konsideruar kufizuese janë larguar ose modifikuar. Prandaj nuk ka qenë e drejtë që ankesa të konsiderohej plotësisht e bazuar. Megjithatë, kam konstatuar edhe mospërputhje konkrete.

Për LOT 1 kanë mbetur pa u harmonizuar tri kërkesa: kërkesa për ekskavator me goma minimum 20 ton, ndonëse sipas vendimit duhej të ndryshohej në minimum 18 ton; kërkesa për rimorkio me pajisje elektrike për sinjalizim të punimeve; si dhe kërkesa për ekskavator me peshë minimale 38 ton, ndonëse sipas vendimit duhej të reduktohej në minimum 26 ton.

Për LOT 2 kam konstatuar se ende janë ruajtur tri standarde ISO – ISO 9001:2015, ISO 3834-2:2021 dhe ISO 39001:2012 – megjithëse vendimi paraprak kishte kërkuar largimin e tyre. Po ashtu kanë mbetur kërkesat për një inxhinier të mbrojtjes së ambientit, një teknik të makinerisë, një specialist të certifikuar si kranist, si dhe dy pajisje të veçanta: çekani hidraulik dhe makina hidraulike për ngjeshjen e dheut që montohet në bager. Edhe këto ishin kërkesa që sipas vendimit të Panelit duhej të largoheshin ose ndryshoheshin. Prandaj, përfundimi im nuk është rezultat i një vlerësimi të ri teknik, por i faktit objektiv se këto kërkesa vazhdojnë të ekzistojnë në dosjen e tenderit pavarësisht vendimit të OSHP-së.

Kam bërë edhe një sqarim tjetër në raport. Në raportin e ekspertëve në lëndën paraprake, në disa raste ishte rekomanduar shtimi i kriterëve të reja. Kam vlerësuar se një rekomandim i tillë nuk duhet të zbatohet, sepse eksperti nuk ka kompetencë të krijojë kriterë të reja të kualifikimit. Kjo është kompetencë ekskluzive e Autoritetit Kontraktues dhe shtimi i kriterëve të reja në këtë fazë do të ishte në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Për këto arsye kam rekomanduar që ankesa të aprovohet pjesërisht, të eliminohen vetëm mospërputhjet konkrete që sapo i përmenda dhe më pas të zgjatet afati për ofertim, në mënyrë që procedura të vazhdojë në përputhje me vendimin e Panelit dhe me parimet e LPP-së. Eksperti shton se kjo lëndë ka qenë mjaft e komplikuar dhe se ka mundur t'i ketë ikur ndonjë pjesë si gabim teknik, pasi vetë dosja nuk ka qenë e kompletuar siç duhet, por edhe ankesa ka qenë e komplikuar. Konsideron se duhet të zbatohet vendimi paraprak i OSHP-së me nr. 283, mirëpo pretendimet që kanë të bëjnë me shtimin e pajisjeve dhe stafit, nëse ka të tilla, nuk i përkrahi, për shtimin e pajisjeve të reja si dhe stafin e ri në DT, vetëm të largohen pajisjet dhe të tjerat sic kanë qenë të parapara me vendimin 283/26.

Anëtarja pyet nëse, përveç pajisjeve, kanë qenë edhe disa pretendime lidhur me inxhinierët. Eksperti përgjigjet se të gjitha pretendimet i ka shqyrtuar, edhe ato që kanë të bëjnë me stafin. Të gjitha pretendimet për të cilat jamë përgjigjur janë të përfshira në ekspertizë dhe qëndrojnë prapa tyre. Nëse nuk kamë shqyrtuar ndonjë pretendim, deklaroj se duhet të respektohet vendimi paraprak, pasi ka mundur t'i ketë ikur ndonjë pretendim pa qëllim si gabim teknik."

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së

tenderit lidhur me aktivitetin e Ndërtimi i Impiantit në Jabllanic të Leshanit LOT 1 Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza LOT 2 Ndërtimi rrjetit të kanalizimit fekal në Lugun e Leshanit me numër të prokurimit 635-26-1622-5-1-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Ndërtimi i Impiantit në Jabllanic të Leshanit LOT 1 Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza LOT 2 Ndërtimi rrjetit të kanalizimit fekal në Lugun e Leshanit me numër të prokurimit 635-26-1622-5-1-1, Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Paneli Shqyrtues obligon Ak që të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim, konform rekomandimit paraprak të OSHP nr. 2026/0283.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES**
- **OE - ENGINEERING GROUP SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: